



REPUBLIKA E KOSOVËS	
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)	
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health	
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)	
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)	
Nr. Protokoll Prot. No.	3832
Nr. Flet Flet. No.	- 15 -
Nr. Datë Date	13.11.25

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

DATE/A:	13.11.2025
PËR/ZA/TO:	- z. Elvir Azizi – Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK-së, - Grupit Punues për hartimin Rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional për punonjësit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës,
NGA/OD/FROM:	- Dr. Tetore Olloni – Kryesuese e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për Miratimin e Rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional për punonjësit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me Nr. Prot: 3815, Datë:12.11.2025.

Të nderuar/a,

Ju njoftojmë se Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), në mbledhjen e mbajtur më 12.11.2025, përveç çështjeve të tjera, ka shqyrtuar kërkesën tuaj për miratimin e Rregullores për edukimin e vazhdueshëm profesional për punonjësit e SHSKUK-së, me Nr. Prot: 3815, datë 12.11.2025.

Pas diskutimeve, Bordi Drejtues i SHSKUK-së ka miratuar Rregulloren në fjalë dhe të njëjtën jua përcjellim së bashku me Vendimin e Bordit Drejtues.

Me respekt,

Bordi Drejtues i SHSKUK-së

- Adresa: QKUK, Nr:10000, Prishtinë

- Nr i tel: 038 512 683



REPUBLIKA E KOSOVËS	
Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK)	
Drejtori i Kliniçkës Universitare të Kosovës (BKUSK)	
Drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (HUCSK)	
Dr. i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës	3831
Nr. i Ligj. 13.11.25	
Dr. i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Nr:17/2025

Datë: 13.11.2025

Prishtinë

Në bazë të Nenin 64 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Nenin 14, Nenin 15, Nenin 16 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës si dhe të Rregullores Nr.01/2024 e Punës së Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Bordi Drejtues i SHSKUK-së në mbledhjen e mbajtur më 12.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për edukimin e vazhdueshëm profesional për punonjësit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me Nr. Prot: 3815, Datë: 12.11.2025.
2. Rregullorja për edukimin e vazhdueshëm profesional për punonjësit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës është pjesë e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dr. Tetore OLLONI

Kryesuese e Bordit Drejtues të SHSKUK-së

Iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues,
- Sekretarit të Bordit Drejtues,
- Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së,
- Kryesueses të Grupit Punues për hartimin e Rregullores për edukim të vazhdueshëm profesional për punonjësit e SHSKUK-së,
- Departamentit Ligjor të SHSKUK-së,
- Arkivit të SHSKUK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



ARHIVI QENDRORE - CENTRAL ARCHIVE - CENTRAL ARCHIVE
No. i dërguar origjinalit / No. i dërguar origjinalit / No. i dërguar origjinalit
Br. sa / Br. sa / Br. sa
Data / Data / Data
13 - 3815
12.11.25

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba
Kosova-

Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinicki Centar Kosova -
University Clinical Center of Kosovo

PËR/ZA/TO:	Bordin Drejtues të SHSKUK				
Përmes:	Elvir Azizi-Drejtor i Përgjithshëm i SHSKUK				
NGA/OD/FROM:	Grupi punues për hartimin e Rregullores për edukim të vazhdueshëm profesional për punonjësit e SHSKUK-me kryesuese: Dr Aferdita Ukimeraj				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJE CT:	Kërkesë oër miratimin e Rregullores për edukim të vazhdueshëm profesional për punonjësit e SHSKUK				
Nr. i zyrës:	Lokacioni	Data:	11.11.2025		
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:			
Room No.:	Extension	Date:			

Të nderuar ,

Bashkëlidhur me këtë shkresë përcjellëse gjeni” Rregulloren për edukim të vazhdueshëm profesional për punonjësit e SHSKUK” të modifikuar sipas propozimeve të anëtarëve të bordit.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government



Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Në bazë të nenit 45 paragrafi 3 i Ligjit nr 04 L125 për Shëndetësi dhe në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 i Statutit të SHSKUK, Bordi Drejtues i SHSKUK në mbledhjen e datës 12.11.2025 miraton këtë:

Rregullore për trajnimet profesionale të punonjësve të SHSKUK

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të rregullojë, përcaktojë, kushtet, procedurat dhe përgjegjësitë për organizimin dhe ndjekjen e trajnimeve profesionale (TP) për të gjithë punonjësit e SHSKUK, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit profesional

Neni 2

Fushëzbatimi

1. Kjo rregullore aplikohet për:
2. Punonjësit shëndetësorë (mjeke, infermier, teknik)
3. Punonjësit administrativ dhe drejtues të njësive të SHSKUK
4. Punonjësit mbështetës të sistemit shëndetësorë

Neni 3

Përkufizimet

1. TP – Trajnim Profesional: aktivitet i planifikuar dhe i strukturuar që ka për qëllim zhvillimin e aftësive dhe njohurive profesionale të individëve

2. Pikët akredituese- Njësia matëse që përcakton vlerën e një aktiviteti në funksion të licencimit dhe ri-licencimit profesional që vlejnë për personelin shëndetësorë
3. Komisioni për TP në SHSKUK:
Një trup ndërinstitucionale përgjegjëse për planifikimin e mbarevajtjen e aktiviteteve TP për personelin e SHSKUK
4. Organizator i trajnimit: Insitucioni ose organizata që planifikon, organizon dhe realizon trajnimin profesional
5. Pjesëmarrës:Individi që merr pjese ne trajnimin profesional për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të tij.
6. Deklarata me shkrim për zotimin e angazhimit: Kjo deklaratë nenkupton se perfituesi i trajnimit, është i obliguar për angazhim pranë institucionit gjegjës së paku edhe për tre vite pas përfundimit të aktivitetit në kuader të TP.
7. Deklarata me shkrim e financimit të dyfishtë: Kjo deklaratë nenkupton se perfituesi i trajnimit nuk pranon mjete financiare për të njëjtin qëllim nga ndonjë burim tjetër.
8. Certifikatë: Dokument që vërteton pjesëmarrjen dhe përfundimin e suksesshem të trajnimit profesional.

Neni 4

Format e trajnimit profesional

Trajnimi profesional mund të realizohet përmes

1. Trajnimeve praktike dhe teorike (për stafin shëndetësor) me prioritet të jenë brenda institucionit e gjithëpërfshirëse, për tërë stafin.
2. Edukimit të organizuar nga partnerët e jashtëm të certifikuar në vend të punës dhe jashtë institucionit.
3. Seminareve, punëtori (për stafin jo shëndetësor) dhe trajnimeve të akredituara-për të gjithë stafin e punësuar në SHSKUK,
4. Praktikave profesionale jashtë vendit.
5. Edukimi në distancë (online) vetëm nëse është ofruar nga institucione të akredituara ndërkombëtarisht dhe përmbush kriteret për përmbajtje, verifikim të pjesëmarrjes dhe testim final.

Neni 5

Organizimi, planifikimi dhe raportimi

1. Drejtoret e Klinikave-njësive në bashkepunim me divizionin për zhvillim në kuadër të BNJ hartojnë planin vjetor për TP i cili përmes komisionit dërgohet për aprovim tek Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK. Planin e aprovuar Drejtoria e SHSKUK e percjell tek komisioni për TP.
2. Njësitë përkatëse brenda institucionit propozojnë prioritetet për zhvillim.

3. Prioritet kanë trajnimet që ndikojnë drejtë për drejtë në rritjen e shërbimeve e avansimin e tyre.
4. Njësitë përbërëse të SHSKUK obligohen ti raportojnë Drejtorisë së Përgjithshme në SHSKUK çdo 6 muaj mbi pjesëmarrjen e stafit në trajnime/aktivitetet e ngritjes profesionale.
5. Raportimi duhet të përmbajë emrat e pjesëmarrësve, llojin e aktivitetit, datën dhe institucionin organizator.
6. Raportet vjetore për realizimin e TP në nivel institucional dorëzohen tek menaxhmenti i SHSKUK.

Neni 6

Detyrueshmëria dhe përgjegjësitë

1. Udhëheqësi i institucionit/njesisë sigurohet që të organizoj punën në shërbim për aq kohë sa përfituesi i trajnimit nuk është në vendin e punës.
2. Pjesëmarrja në TP është detyrim profesional dhe institucional.
3. SHSKUK, duhet të sigurojë mundësi për trajnime të brendshme dhe të jashtme, dhe personeli ka obligim t'i ndjekë ato.
4. Mos-pjesëmarrja e pa arsytuar përbën shkelje dhe mund të pasohet me masa administrative.
5. Mos respektimi i pikave të këtij neni (pikat 2,3 dhe 4) mund të ndikojë në vlerësimin vjetor të performancës .
6. Nëse ndonjëri nga aktivitetet në kuadër të TP ofrohet në njësitë përbërëse të SHSKUK-se, atëherë ky aktivitet i organizuar jashtë organizatës -SHSKUK nuk do të aprovohet nga Komisioni për TP. Përgjatshim bëjnë rastet te cilat kanë të bëjnë me aktivitetet që përfshijnë procedura më të avansuara.

Neni 7

Kriteret për përfitim nga mbështetja për pjesëmarrje në aktivitete profesionale

1. Aplikuesi duhet të jetë punonjës në SHSKUK.
2. Duhet të jetë i punësuar me orarë të plotë në SHSKUK apo njësitë e saj përbërëse.
3. Ka të drejtë të aplikojë për pjesëmarrje vetëm në aktivitete që i përkasin fushës së tij/saj të specializimit.
4. Aplikimi duhet të bëhet përmes drejtorit/udhëheqësit të institucionit, i protokoluar në njësitë përkatëse dhe dorëzohet në arkiven qendrore në SHSKUK për Komisionin e TP-së.
5. Aplikuesi duhet të sjellë: Miratimin për pranim nga institucioni, programin e detajuar të trajnimit, kohëzgjatjen e trajnimit, dhe dëshmi për kosto tjera (shpenzimet e udhëtimit, akomodimi, kuotizimi).

6. Përfitimi i mjeteve financiare për TP, realizohet pas përfundimit të trajnimit me dëshmi të shpenzimeve financiare. Këto mjete rimbursohen pasi të plotësohet forma për rimbursim me dëshmitë e shpenzimeve të aprovuara nga Komisioni.
7. Kandidati (perfituesi i trajnimit) njohuritë e përfituara duhet ti aplikoj në punë dhe te njejtat ti barti tek koleget e tyre përmes prezenteve dhe punës praktike.
8. Duhet të jetë njohës i gjuhës në të cilën mbahet tubimi/trajnimi.
9. Duhet të ketë rol aktiv në aktivitet (të përfitojë njohuri në aspektin teorik dhe praktik) që justifikon ndarjen e mbështetjes financiare.
10. Certifikatat dhe dëshmitë tjera rreth përfundimit të aktivitetit duhet ti sjell në Njësinë e Burimeve Njerëzore për ti vendosur në dosjen personale.
11. Ka të drejtë për përkrahje financiare vetëm një herë brenda vitit kalendarik.
12. Nuk duhet të jetë nën procedurë disiplinore ose administrative nga institucioni ku punon.
13. Nuk duhet të jetë nën procedurë disiplinore për shkelje etiko-profesionale apo masa të tjera nga OMK.
14. Nuk duhet të jetë nën hetim penal ose të ketë vendim fajësues për vepra penale të kryera me dashje.
15. Kandidati (aplikuesi) i kërkesës nuk duhet të jetë mbi moshën 60 vjeçare.
16. Aplikuesi është obliguar të nënshkruaj deklaratën me shkrim për zotimin e angazhimit, kjo formë duhet të dorëzohet në rastin e aplikimit.
17. Aplikuesi është i obliguar të nënshkruaj një deklaratë mbi financimin e dyfishtë, në momentin e aplikimit.

Neni 8

Kriteret për përfitim të përkrahjes financiare për ofruesin e trajnimit profesional

1. Profesionisti kompetent për ofrim të trajnimit duhet të jetë anëtar i Odës së Mjekëve (në rastin kur profesionisti është mjek) në vendin e origjinës apo vendin ku e ushtron profesionin.
2. Duhet të ketë licencë valide të punës, me vlefshmëri së paku një vit nga momenti i aplikimit, lëshuar nga vendi i origjinës apo vendi ku ushtron profesionin.
3. Ka të drejtë të aplikojë për ofrimin e shërbimit vetëm në kuadër të EVP-së, për pjesëmarrje që lidhet me fushën e specializimit të tij/saj, apo të ketë thirrje shkencore apo akademike në fushën e mjekësisë apo në fushën përkatëse të specializimit.
4. Duhet të jetë njohës i gjuhës angleze ose i njërës nga gjuhët zyrtare të përdorura në Republikën e Kosovës.
5. Duhet të ketë rol aktiv në aktivitetin për të cilin ftohet (p.sh. ligjërues, trajner ose mentor), me qëllim që të ofrojë më shumë njohuri teorike e praktike për stafin vendor. Në këtë rast, do t'i mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit si dhe dieta ditore sipas Rregullorës (QRK) nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit.
6. Nuk duhet të jetë nën procedurë administrative ose disiplinore, dhe nuk duhet të ketë masë në fuqi të shqiptuar nga institucioni përkatës në vendin e origjinës apo në vendin ku ushtron profesionin.

7. Nuk duhet të jetë nën procedurë disiplinore për shkelje etiko-profesionale dhe nuk duhet të ketë masë të shqiptuar nga Oda e Mjekëve të vendit të origjinës apo vendit ku e ushtron profesionin.
8. Nuk duhet të jetë nën hetim penal dhe nuk duhet të ketë vendim fajësues në fuqi për vepra penale të kryera me dashje nga organet gjyqësore të vendit të origjinës apo të vendit ku ushtron profesionin.

Neni 9

Komisioni për TP

1. Për zbatimin e TP krijohet Komisioni për TP
2. Komisioni ka këto përgjegjësi:

2.1. Te shqyrtoj aktivitetet trajnuese

2.2. Te pranoj vetëm kërkesat/aplikimet e menaxhmenteve të SHSKUK, për trajnime që janë në përputhje me Rregulloren.

2.3. Klasifikon aktivitetet sipas përmbajtjes, llojit dhe kohëzgjatjes së tyre.

2.4. Mirëmban një bazë të dhënash në formë elektronike rreth aplikimeve, refuzimeve dhe aprovimeve të lëndëve.

2.5. Dorëzon raport në Drejtorinë e SHSKUK për vlerësimin/aprovimin e trajnimeve.

Neni 10

Thirrjet publike për organizatat trajnuese

1. SHSKUK ka të drejtë të publikojë thirrje të hapura për bashkëpunim me organizatat publike ose private që ofrojnë trajnime profesionale të akredituara
2. Thirrjet publike do të përfshijnë:
 - Fushat e interesit për trajnim
 - Aftatet kohore për aplikim dhe realizim të aktivitetit, format dhe mënyrën e vlerësimit të aktivitetit
 - Organizatat e interesuara duhet të ofrojnë:
 - Dokumentacionin ligjor të regjistrimit
 - Programin e trajnimit me objektiva të qarta dhe përmbajtje adekuate
 - Referencat nga bashkëpunimet e mëparshme e dëshirueshme
3. Bashkëpunimi me organizatat formalizohet me marrëveshje bashkëpunimi në përputhje me statutin e SHSKUK

Neni 11

Evidenca dhe certifikimi

1. Pas përfundimit të suksesshëm lëshohet certifikata.
2. Certifikatat arkivohen në dosjet e punonjësit.
- 3.

Neni 12

Mbështetja Financiare dhe Organizative

1. SHSKUK, në koordinim me institucionet e tjera përkatëse, do të përkrahë financiarisht dhe logjistikisht pjesëmarrjen e punonjësve në aktivitetet prioritare.
2. Prioritet do t'u jepet trajnimeve që lidhen me shërbimet për pacientin, përdorimin e teknologjisë së re dhe avansimin e tyre drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në pergjithësi.
3. Shpenzimet të cilat mbulohen nga SHSKUK janë: kuotizimi, bileta e udhëtimit, banimit (hotelit).
4. Shpenzimet ditore realizohen konform Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit.
5. Pagesa mund të realizohet pasi që të sillet dokumentacioni dëshmuës i pjesëmarrjes në aktivitet dhe certifikata e përfituar.
6. Mjetet e aprovuara do ti transferohen aplikuesit në xhirollogarine e tij/saj personali nga departamenti i financave të SHSKUK.

Neni 13

Vlerësimi dhe Rishikimi i Rregullores

Kjo rregullore do të vlerësohet çdo vit nga Bordi Drejtues në SHSKUK, dhe nëse është e nevojshme, do të rishikohet për t'iu përshtatur zhvillimeve të reja profesionale dhe nevojave institucionale.

Neni 14

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së njejtë të miratimit
2. Kjo rregullore nuk cenon dispozitat e memorandum bashkëpunimit mes SHSKUK-OMK lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional e cila përfshinë trajnimet me kohëzgjatje deri në 3 muaj.

3.Kjo rregullore permban 4 shtojca te standardizuara: 1) Deklarate për zotimin e vazhdimet të shërbimit. 2) Deklaratën mbi financimin e dyfishtë, 3) Forma e rimbursimit, 4) Formular i aplikimit.

Neni 15

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

-Kjo rregullore hyn ne fuqi pas miratimit te saj nga Bordi i SHSKUK dhe zbatohet në të gjitha njësitë që funksionojnë brenda SHSKUK.

Nëntor, 2025

Kryesuesja e Bordit Drejtues në SHSKUK

Petru Ollou

Shtojca 1 Deklarata per zotimin e vazhdimet te shërbimit



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetska Bolnica i Klinički Služba Kosovo (UBESK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)



DEKLARATË PËR ZOTIMIN E VAZHDIMIT TË SHËRBIMIT

Unë, i/e nënshkruari/a _____ (me numër personal _____), i/e punësuar në _____

(njësi/klinika/shërbimi) në kuadër të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), me anë të kësaj deklarate, zotohem se pas përfundimit të trajnimit profesional me mbështetje financiare nga institucioni, do të vazhdoj shërbimin në kuadër të këtij institucioni për një periudhë minimale prej tre (3) vitesh.

Jam i/e vetëdijshëm/ se:

1. Ky zotim përben detyrimin e këtij institucioni që ka mundësuar trajnimin tim me pagesë.
2. Në rast se ndërprea marrëdhënien e punës para përfundimit të afatit të përcaktuar (3 vite nga përfundimi i trajnimit), obligohem të kthej shpenzimet financiare të mbuluara nga institucioni për këtë trajnim, që përputhet me rregulloren, që bëj.
3. Kjo deklarata është pjesë përbërëse e dokumentacionit zyrtar të trajnimit dhe do të ruhet në dosjen time personale.

Në shenjë pajtimi, nënshkruaj këtë deklarata sot, më datë _____, më _____.

Punonjësi:

Emri dhe mbiemri: _____

Pozita: _____

Nënshkrimi: _____

Shtojca 2 Deklarate mbi financimin e dyfishte:



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
MINISTRY OF HEALTH
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK) Univerzitetske Bolničke i
Kliničke Službe Kosova (UEKSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës Univerzitetski Klinički
Centar Kosova University Clinical Center of Kosovo

DEKLARATË MBI FINANCIMIN E DYFISHTË

Deklaroi se:

Aplikuesi:

Përcakto njërin nga opsionet

a) Nuk ka pranuar.

Financim për projektin e trainimit nga burime tjera financiare për të njëjtin trainim

Ose

b) Ka konkuruar

Për financimin e trainimit/programit, por procesi i vlersimit të projektit/trainimit është ende në proces.

(Emri i institucionit në të cilin kandidati ka konkuruar)

Nën përgjegjësi penale dhe materiale deklaroi se të gjitha informata e përfshira në deklaratë janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Vendi dhe data:

Emri Mbiemri dhe nënshkrimi

Shtojce 3: Forma për rimbursim



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
MINISTRY OF HEALTH
Shërbimi Spitalor dhe Klinike Universitar i Kosovës (SHSK/UK) Universitetske Bolničke i
Kliničke Službe Kosova (UKSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës Univerzitetski Klinički
Centar Kosova University Clinical Center of Kosovo

Forma per rimbursim

Emri Mbiemri	
Mbaitesi / Ilogarise	
Emri i Bankes	
Numri IBAN	
Kodi SWIFT/BIC	
Adresa e perfituesit (marresit)	

Data	Pershkrimi	Projekti	Vlera

Total: €

Data & nenshkrimi

Shtojce 4: Formulari i aplikimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
MINISTRY OF HEALTH

Bërbëmi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK) Universitetske
Bolničke i Kliničke Službe Kosova (UBKSK)

The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosovës Univerzitetski
Klinički Centar Kosova University Clinical Center of Kosovo

FORMULAR PËR TRAJNIM PROFESIONAL – ME PAGESË NGA INSTITUCIONI

Për kandidatin: _____

Të ceket lloji dhe procedura mjekësore e trajnimit profesional specifik:

Miratimi me fletë-përcjellëse nga drejtori i klinikës, spitalit apo institucionit tjetër.

Kobëzgjatja: _____

Shuma e mjeteve të kërkuara: _____

Data e fillimit: _____

Data e përfundimit: _____

Dokumentacioni tjetër përcjellës:

Të bashkëngjitet dokumentacioni përkatës, duke përfshirë institucionin ku shkon profesionisti mjekësor apo punëtori i SHSKUK, si dhe agjendën e detajuar të trajnimit.

Kandidati që ka ndjekur trajnimin obligohet që aftësitë e fituara të përcjellë tek kolegët e tjerë dhe të ofrojë dëshmi me shkrim (certifikatat e përmarrjes) sekcionit e personelit në pjesën ku ai/ajo punon.

Drejtori i Klinikës/Spitalit/Institucionit
